

REPublika e Kosovës/REPublika KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-364

Data/Datum/Date: 08/04/2021

Shtojca/Dodaci/Annex: -2-

PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republik of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 72/2021
Datë: 08/04/2021.

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, (26.03.2021), Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Metije Ademi, Drejtore e Drejtoratit për Lirim me Kusht dhe Programe në Shërbimin Sprovues caktohet Zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. E caktuara nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në nenin 22 (paragrafi 4), ka përcaktuar se: në rastet e agjencive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, në ligjin e themelimit të agjencisë mund të përcaktohet që drejtori ekzekutiv të mbështetet nga jo më shumë se (2) dy zëvendës drejtorë."

Për të sqaruar çështjen e përcaktimit të pozitës së zëvendës drejtorit të agjencisë ekzekutive, se përcaktimi i një pozitë të tillë a është çështje që duhet përcaktuar me ligj apo me akt të brendshëm, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Ministrisë përgjegjëse për

Punë të Brendshme, e cila në opinionin e datës 07.04.2021, në linjë për përcaktimet ligjore të theksuara më lartë konstaton se pozita e zëvendës drejtorit të një agjencie ekzekutive është çështje që duhet të përcaktohet me ligjin e themelimit të agjencisë.

Kurse, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. L/129, ligj i cili përcakton ndër të tjera edhe strukturën, funksionimin dhe përgjegjësitë e Shërbimit Sprovues, përkatësisht neni 238 (paragrafi 3 dhe 4) përcakton si në vijim: “Zyra Qendrore e Shërbimit Sprovues e përcjell dhe mbikëqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësisve organizative të Shërbimit Sprovues dhe të zyreve rajonale sprovuese. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Sprovues, themelohen drejtoritë dhe sektoret...”.

Me çka konstatohet se Ligji i cekur më lartë, nuk ka përcaktuar pozitën e zv. Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Sprovues.

Andaj, meqenëse pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSK-së ka mbetur vakante, si dhe me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë të punës brenda fushëveprimtarisë së SHSK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Znj. Metije Ademi;
- Kabinetit të Ministrit;
- Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;